



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1316/1 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 7, datë 09.10.2024

PËR

**MIRATIMIN PARAPRAK TË RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E PËRFITIMIT
TË LEJEVE NGA PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËSAKADEMIK DHE
ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “a”, në nenin 38, pika 1, gërma “d” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24, pika 1, gërma “g” të Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Nr. 1316 Prot., datë 08.10.2024, me lëndë “Dërgohet propozimi për miratimin e draft-rregullores për lejet”, miratuar paraprakisht nga Rektori, pasi e shqyrtoi dhe diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:


1. Miratimin paraprak të Rregullores “Për procedurën e përfitimit të lejeve nga personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ në Universitetin e Arteve”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

PROF. ASOC. KRISTINA LAÇO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

RREGULLORE E BRENDSHME

PËR

PROCEDURËN E PËRFITIMIT TË LEJEVE NGA
PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËSAKADEMIK
DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE

Miratuar me VSA nr. 7, datë 09.10.2024



PËRMBAJTJA

Qëllimi

Baza ligjore

Fusha e zbatimit

Afatet dhe procedurat

Sanksionet

Dispozita të fundit



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME: QËLLIMI, BAZA LIGJORE, FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për trajtimin e rasteve kur punëmarrësi përfiton nga leja vjetore, leja për aktivitete që lidhen me drejtimet e punës së personelit akademik dhe leja që mundësohet për prindin e ri, gratë shtatzëna dhe nënat e reja.

Neni 2

Baza ligjore

Bazat kryesore ligjore të kësaj rregulloreje janë ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, akte të tjera ligjore të dala për këtë qëllim, Statuti dhe Rregullorja e UART.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për çdo punonjës të Universitetit të Arteve, përfshirë këtu personelin akademik, ndihmësakademik dhe atë administrativ.

KREU II

E DREJTA E PËFITIMIT TË LEJES DHE PUSHIMIT. PROCEDURA.

Neni 4

E drejta e përfitimit të lejes së paguar nga personeli

1. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike).
2. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore për personelin administrativ dhe ndihmësakademik është jo më pak se 22 ditë pune gjatë vitit të punës në vazhdim.



3. Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.
4. Pushimet vjetore, sipas pikës 1 dhe 2, duhet të jepen gjatë vitit të punës ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës, por gjithmonë në përputhje me strukturën vjetore akademike.
5. Personeli ka të drejtë t'i kryejë pushimet brenda tre vjetëve nga dita në të cilën i lind kjo e drejtë, në rastet kur:
 - a. Titullari i institucionit nuk miraton kryerjen e pushimeve vjetore;
 - b. I punësuari nuk i merr pushimet vjetore, me kërkesë të tij dhe pas miratimit të mosmarrjes së pushimit nga titullari;
 - c. I punësuari shkëputet nga leja vjetore me urdhër të titullarit.

Për personelin akademik, për lejen e pakonsumuar, si pasojë e nevojës së institucionit, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, drejtuesi i njësisë kryesore, përcakton kompensimin në ditë pushimi, në përputhje me strukturën e vitit akademik.
6. I punësuari në Universitetin e Arteve, ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet, si më poshtë vijon:
 - a) martesa e tij – 5 (pesë) ditë;
 - b) lindja e fëmijës për bashkëshortin/bashkëjetuesin – 3 (tri) ditë;
 - c) vdekja e bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindërve, gjyshërve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij – 5 (pesë) ditë.
7. Nëse ditët që mbulon raporti mjekësor përkojnë me ditët e lejes vjetore, apo nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet.

Neni 5

E drejta e përfitimit të pushimeve të papaguara

1. Personeli akademik mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, për arsye shëndetësore apo familjare.
2. Personeli ndihmësakademik dhe administrativ, mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, në rastet e sëmundjeve të rënda të anëtarëve të familjes, bashkëjetuesit, prindërve ose pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë.
3. Kohëzgjatja e pushimit pa të drejtë page, përcaktohet nga titullari i institucionit, me propozimin e eprorit direkt të lejekërkuarit dhe në çdo rast, kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.



Neni 6
E drejta e përfitimit të lejes për aktivitete

Personeli akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimet e punës së tij, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë brenda vitit akademik, me miratim nga drejtuesi i njësisë kryesore, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori.

Neni 7
Procedura e njoftimit të punëdhënësit për përfitimin e lejes

1. Kërkesa për leje afat-shkurtër për aktivitete artistike apo pjesëmarrje në konferenca, simpoziume, workshop-e, masterklase dhe projekte shkencore, duhet të dorëzohet jo më pak se 5 (pesë) ditë para aktivitetit.
2. Kërkesa për leje të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përveç rasteve emergjente shëndetësore apo familjare, duhet të dorëzohet jo më pak se 10 (dhjetë) ditë përpara datës së fillimit të lejes.
3. Përgjigjia mbi kërkesën për leje merret brenda 2 (dy) ditëve pune.
4. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të iniciohen nga plotësimi i formularit për leje në Fakultet/Rektorat dhe duhet të përcillen pranë DMBNJ, së bashku me dokumentacionin justifikues (ftesa e aktivitetit, raporti mjekësor, raporti nga mjeku për shoqërim të familjarit për sëmundje etj).
5. Përveç sa parashikohet në pikën 4, kur leja merret për aktivitete që lidhen me drejtimet e punës së personelit akademik, ky i fundit raporton përpara departamentit mbi aktivitetin e kryer gjatë lejes.

KREU III

**LEJET DHE PUSHIMET: E DREJTA E PËRFITIMIT TË LEJES QË
MUNDËSOHET PËR PRINDIN E RI, GRATË SHTATZËNA DHE NËNAT
REJA. PROCEDURA.**

Neni 8
Afatet dhe procedura e njoftimit të punëdhënësit nga gratë shtatzëna

1. Gratë shtatzëna, të pajisura me raportin mjekësor 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, njoftojnë me shkrim DMBNJ të paktën 1 javë para se të fillojë afati i përcaktuar në ligj. Kur gruaja shtatzënë ka në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e parë bëhet 60 ditë.



2. Nëse gruaja shtatzënë nuk dëshiron të nisë lejen e lindjes para lindjes së fëmijës, ajo duhet në çdo rast të njoftojë DMBNJ për gjendjen e saj shëndetësore, në mënyrë që të merren masa nga ana e punëdhënësit për t'i ofruar asaj një mjedis të sigurt në punë.
3. Pas periudhës 63-ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore.

Neni 9

Afatet dhe procedura e njoftimit të punëdhënësit nga nënat e reja në rastin e birësimit

1. Në rast birësimi të një fëmije të moshës deri në 1 vjeç dhe kur gruaja ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ajo ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se pas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës.
2. Gruaja ka detyrimin të njoftojë me shkrim DMBNJ të paktën 1 javë para se të fillojë afati i përcaktuar në ligj.

Neni 10

Afatet dhe procedura e njoftimit të punëdhënësit për përfitimin nga leja e paslindjes për baballarët e rinj

1. Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.
2. Për të përfituar nga kjo e drejtë, babai i ri ka detyrimin të njoftojë me shkrim DMBNJ të paktën 1 javë para se të fillojë afati i përcaktuar në ligj.

KREU IV

SANKSIONET

Neni 11

Masat disiplinore dhe gjobat

1. Në rast se konstatohen shkelje të rregullores, ndaj shkelësve do të merren masa dhe/ose do të aplikohen gjoba, sipas rastit.
2. Procedurat për dhënie të masave disiplinore si dhe kriteret, përcaktohen në Statutin e Universitetit të Arteve, Kodin e Etikës dhe akte të tjera të brendshme. Në caktimin e masave disiplinore nuk ndiqet rradhë nga masa më e lehtë në masën më të rëndë disiplinore.
3. Llojet e masave disiplinore janë si më poshtë:
 - a) vërejtje verbale.....deri në 6 (gjashtë) muaj;
 - b) vërejtje me shkrim.....deri në 1 (një) vit;
 - c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë.....deri në 1 (një) vit;



- d) ulje në detyrë..... deri në 1 (një) vit;
 - e) vërejtje me paralajmërim për largim nga puna.....deri në 1 (një) vit;
 - f) largim nga puna në Universitetin e Arteve.
3. Masa të tjera përfshijnë ndërprerjen e ditës së punës, apo gjobë deri në tridhjetëfishin e pagës minimale mujore (për shkelje të dispozitave 91-96 të Kodit të Punës).
4. Kur shkelja përbën vepër penale, zbatohen dispozitat e Kodit Penal.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12
Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e detyrueshme për të gjithë punonjësit e Universitetit të Arteve.

Tiranë, më 09.10.2024

